



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 98/13

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data / Datum 25. 04. 2013

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **25.04.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme të Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme të Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 26.04.2013 dhe zgjatë deri më 20.05.2013.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

#### **Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Arsimit që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.


Gjithashtu DA-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Maj 2013.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **25.04.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Dhënien e Dekorativave të Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Dhënien e Dekorativave të Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 26.04.2013 dhe zgjatë deri më 20.05.2013.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

#### **Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Maj 2013.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	96/13
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data / Datum	25. 04. 2013
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 44.1 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-16, nenit 17.2 të Ligjit mbi planifikimin hapësinor Nr.2003/14, nenit 6.3 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, dhe nenit 40 "k" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **25.04.2013**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**MBI LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË TOKËS**  
**BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE**

**Neni 1**

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të përhershëm nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e cila është evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70202028-00145, parcela kadastrale Nr.436/0, vendi i quajtur "arat mbi fshat" me kulturë arë e klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 00.24.22 ha, Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm, pronë e Afrim Mehmetit nga Prishtina, rr. "Ibrahim Kelmendi".

**Neni 2**

Obligohet pronari i ngastrës nga neni 1 i këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të përhershëm të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 "a" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, ku parashikohet 0.75 €/m<sup>2</sup> përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

**Neni 3**

Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimi në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 95/13

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datumi 25.04.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **25.04.2013**, mori këtë:

## V E N D I M PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS

### Neni 1

1.1. Me këtë vendim ridestinohen mjetet nga fondi 10, nga kategoria e investimeve kapitale (programi 664250, Planifikimi Urban dhe Mjedis) nga ky projekt:

1.1.1. Asfaltimi i rrugës në fshatin Sfaracak në vlerë 60,000.00 € (gjashtëdhjetë mijë euro), shuma e mjeteve të lira buxhetore 4,169.70 (kodi i projektit 88534), nga ky projekt ridestinohet në këto projekte që janë në realizim.

### Neni 2

Nga projekti i cekur në nenin 1 të këtij vendimi ridestinohen mjetet në shumën prej 4,196.70 € në të njëjtin program buxhetor, në këto projekte:

2.1. Projekti: Asfaltimi i rrugëve lokale në fsh. Mihaliq-lagjja "Mustafa", kodit 88509, shuma prej 944.00 €;

2.2. Projekti: Asfaltimi i rrugëve lokale në fsh. Bivolak, kodit 88508, shuma prej 2,230.50 €;

2.3. Projekti: Asfaltimi i rrugës në fsh. Reznik-Shalë, kodit 84386, shuma prej 995.20 €.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

### Neni 4


Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

  
Habib Mustafa







**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 11, 12.2 "d" dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 5 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.34/2012 për pagesën e pagave dhe shtesave të kryetarëve/kryesuesve dhe të anëtarëve të bordit për rishqyrtimin e ankesave, komiteteve të auditimit, Këshillit Kosovar për raportin financiar dhe nenit 39 paragrafi 39.1 dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **25.04.2013**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENSIMIT PËR KOMITETIN PËR**  
**AUDITIM**

**Neni 1**

Me këtë vendim përcaktohet lartësia e pagesës për Kryesuesin dhe anëtarët e Komitetit për Auditim të Komunës së Vushtrrisë për pjesëmarrje në mbledhjet e komitetit, si vijon:

1.1. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit për pjesëmarrje në çdo mbledhje kompensohet nga 120.00 € (njëqind e njëzet euro);

1.2. Anëtarët e Komitetit të Auditimit për pjesëmarrje në çdo mbledhje kompensohen nga 100.00 € (njëqind euro).

**Neni 2**

Pagesa e cekur si në nenin paraprak do të bëhet nga mjetet buxhetore të komunës (pagat dhe mëditjet).

**Neni 3**

Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit do të paguhen më së shumti 6 mbledhje brenda një viti.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e KK-së.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimi në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 6**

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i KK-së 01Nr.67/11, të datës 28.04.2011.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VI SHITËRRISE - OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 93/13

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data / Datum 25.04.2013

VUSHTRRI - VUÇITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 11 dhe 12 "d" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe kërkesës së Burim Ahmetit, të datës 19.04.2013, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25.04.2013**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDIHMË FINANCIARE PËR MJEKIM**

**Neni 1**

Me këtë vendim z. Burim Ahmetit nga Vushtrria i ndahen mjete financiare nga buxheti i komunës- fondi për transfere dhe subvencione i Zyrës së Kuvendit (Grupi i Grave Deputete) në shumë prej 5.000 € (pesë mijë euro) ndihmë për shpenzime të mjekimit të vajzës së tij Liberta Ahmeti.

**Neni 2**

Pagesa e mjeteve duhet të bëhet pas ofrimit të dëshmisë me shkrim (dokumentacionit mjekësor) lidhur me diagnostifikimin e sëmundjes - caktimin e diagnozës së të lartpërmendurës.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	92/13
Nr. i fq. / Br. sh	- 1 -
Data: / Datum	25.04.2013
VUSHTRRI - VUČITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **25.04.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Shërbime Komunale të Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Shërbime Komunale të Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 26.04.2013 dhe zgjatë deri më 20.05.2013.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

#### **Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Maj 2013.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 91/13

Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 25. 04. 2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 4 të Rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale Nr.19-1/13, dt.31.01.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **25.04.2013**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFYTËZIM**  
**AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE**

**Neni 1**

Me këtë vendim formohet komisioni për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale në këtë përbërje:

- 1.1. Habib Mustafa, kryesues i kuvendit të komunës (kryesues i komisionit);
- 1.2. Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit të komunës (zëvendës kryesues);
- 1.3. Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit të komunës;
- 1.4. Tefik Maloku, agronom në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim;
- 1.5. Ramiz Maliqi, zyrtar në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- 1.6. Hyda Dallku, zyrtar në Drejtorinë për Prokurim Publik;
- 1.7. Isak Hyseni, përfaqësues i shoqërisë civile.

**Neni 2**

Mandati i komisionit është i njëjtë me mandatin e tanishëm të anëtarëve të kuvendit të komunës.

**Neni 3**

- 3.1. Komisioni ushtron të gjitha përgjegjësitë, kompetencat dhe të drejtat e përcaktuara konform Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, dhe Rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale 01 Nr.19-1/2013, dt. 31.01.2013.
- 3.2. Ky komision është autoriteti për vlerësimin final të ofertave ekonomikisht më të favorshme, në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand dhe shprehje të interesit.

**Neni 4**

Komisioni gjatë punës së tij duhet të respektoj parimin e transparencës, trajtimit të barabartë të palëve, vlerave unike të pronës dhe ruajtjes së mjedisit.

**Neni 5**

Komisioni për vlerësim shqyrton të gjitha ofertat e arritura duke pasur parasysh kriteret që përcaktojnë fituesin, e që janë: arsyeshmëria ekonomike, lloji i veprimtarisë, rritja e punësimit dhe çmimi më i lartë i ofruar i qirasë.



#### **Neni 6**

Komisioni pas përfundimit të procedurave të vlerësimit të ofertave ia dërgon kuvendit të komunës për aprovim ofertën ekonomikiht më të favorshme të përzgjedhur.

#### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, anëtarët e komisionit vlerësues, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Zyra Ligjore.

#### **Neni 8**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimi në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**

